VENDIM
Nr.92, datë 24.3.2011

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E DREJTIMIT DHE VEPRIMTARISË SË ORGANEVE DREJTUESE DHE SHËRBIMEVE TË KUVENDIT PËR PERIUDHËN SHTATOR 2005 - DHJETOR 2010 NGRITUR ME VENDIMIN NR.90, DATË 17.3.2011

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit dhe neneve 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Erjon Braçe zgjidhet kryetar i komisionit hetimor të Kuvendit "Për hetimin e drejtimit dhe veprimtarisë së organeve drejtuese dhe shërbimeve të Kuvendit për periudhën shtator 2005 - dhjetor 2010", ngritur me vendimin nr.90, datë 17.3.2011.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)